

*Inform ke rrethuar  
17.06.07  
16/7/07  
G.M.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Këshilli i Ministrave

*6840  
18.06.07*

*20/6/07  
Z. R. G. G. G.  
Z. R. G. G. G.*

*16/7/07  
26.06.07*

V E N D I M

Nr. 346, datë 6.6.2007

P Ë R

MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES, NDËRMJET QEVERISË  
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË  
SË SPANJËS, PËR BASHKËPUNIM DHE NDIHMË TË NDËRSJELLË NË  
ÇËSHTJET E DOGANAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7, të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998, « Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare », me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Spanjës, për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë në çështjet e doganave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI


SALI BERISHA

MINISTRI I FINANCEVE

RIDVAN BODE

NR.PROT.962/3  
DATË 14.6.2007

PRESIDENCËS  
MINISTRISË SË FINANCAVE  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME  
MINISTRISË SË INTEGRIMIT  
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË  
DHE ENERGJETIKËS  
MINISTRISË SË BRENDSHME  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE



Marrëveshje ndërmjet  
Qeverisë së Republikës së Shqipërisë  
dhe  
Qeverisë së Mbretërisë së Spanjës  
në lidhje me  
Bashkëpunimin e Ndihmës së Ndërsjelltë në Çështjet e Doganave

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Spanjës, më poshtë të referuara si Palët,

Duke marrë parasysh se veprat penale kundër legjislacionit të doganave dëmtojnë interesat ekonomike, fiskale dhe shoqërore të Shteteve përkatëse, si dhe interesat e ligjshme të tregtisë,

Duke marrë parasysh se trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike, substancave psikotrope dhe mallrave të tjera të dëmshëm përbëjnë rrezik për shëndetin publik dhe për shoqërinë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e sigurimit të saktë të vlerësimit të tarifave doganore dhe taksave që vilen gjatë importimit dhe eksportimit të mallrave dhe të zbatimit të rregullt të dispozitave për ndalimin, kufizimin dhe kontrollin,

Të bindur që përpjekjet për parandalimin e veprave penale kundër legjislacionit të doganave dhe përpjekjet për të siguruar vjeljen e saktë të tarifave dhe taksave të importit dhe eksportit mund të bëhen më të efektshme nëpërmjet bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve doganore,

Duke marrë në konsideratë Rekomandimin e Këshillit të Bashkëpunimit të Doganave mbi Ndihmën e Ndërsjelltë Administrative të 5 dhjetorit 1953,

Duke marrë në konsideratë Konventën e vetme për Lëndët Narkotike (Nju Jork, 1961), Konventën për Substancat Psikotrope (Vjenë, 1971) dhe Konventën kundër Trafikut të Paligjshëm të Lëndëve Narkotike dhe Substancave Psikotrope (Vjenë, 1988).

Kanë rënë dakord si më poshtë:

## Neni 1

### Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

- a) "Autoritet doganor" është:
- Në Republikën e Shqipërisë: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Ministrinë e Financave,
  - Në Mbretërinë e Spanjës: Ministria e Ekonomisë dhe Financave, pa cënuar kompetencat që u takojnë Ministrive të tjera.
- b) "Legjislacioni i doganave" është çdo dispozitë ligjore osë nënligjore e zbatuar nga autoritetet doganore që rregullon importin, eksportin dhe tranzitin e mallrave, dhe çdo procedurë apo regjim doganor që ka të bëjë më tarifrat ose taksat doganore apo masat për ndalimin, kufizimin ose kontrollin, duke përfshirë trafikun e paligjshëm të drogës dhe mallrave të tjera,
- c) "Vepra penale" është çdo shkelje e legjislacionit të doganave, si dhe çdo shkelje e këtij legjislacioni e mbetur në tentativë,
- d) "Tarifat doganore" janë të gjitha tarifrat, taksat dhe pagesat që caktohen dhe vilen nga autoritetet doganore,
- e) "Person" është çdo person fizik dhe juridik,
- f) "Autoritet kërkues" është autoriteti doganor që bën një kërkesë për ndihmë në çështjet e doganave,
- g) "Autoritet i kërkuar" është autoriteti doganor që merr një kërkesë për ndihmë në fushën e doganave,
- h) "Dorëzim i kontrolluar" është teknika e lejitimit të dërgesave të paligjshme që përmbajnë ose dyshohet të përmbajnë lëndë narkotike, substanca psikotrope, substanca zëvendësuese të tyre, ose mallra delikate të dalin, kalojnë ose futen në territoret e Palëve me dijeninë ose nën mbikqyrjen e autoriteteve kompetente për qëllimet e hetimit të hetimeve.

## Nëni 2

## Objekti i Marrëveshjes

1. Autoritetet doganore të Palëve ndihmojnë njëra-tjetrën në kushtet e përcaktuara në këtë Marrëveshje për të lehtësuar lëvizjen e ligjshme të mallrave, për të zbatuar legjislacionin doganor edhe në parandalimin, hetimin dhe luftën kundër veprave penale në fushat e sipërpërmendura.
2. Ndihma e ndërsjelltë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje jepet në pajtim me legjislacionin në fuqi në territorin e Shtetit të Palës së kërkuar dhe brenda kompetencës dhe burimeve në dispozicion të autoritetit doganor të kërkuar.
3. Përmbajtja e kësaj Marrëveshjeje nuk cënon ndihmën e ndërsjelltë në lidhje me çështjet penale që jepet në pajtim me legjislacionin në fuqi në territoret e Palëve dhe me Marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga Palët.

## Neni 3

## Ndihma sipas kërkesës

1. Me kërkesë të autoritetit kërkuar, autoriteti i kërkuar i jep autoritetit kërkuar informacionin e nevojshëm në lidhje me:
  - a) zbatimin e përshtatshëm të legjislacionit doganor dhe ndryshimet thelbësore në këto legjislacione,
  - b) vlerësimin e saktë të tarifave doganore, veçanërisht atë informacion që ka të bëjë me përcaktimin e vlerës doganore, klasifikimin e tarifave dhe origjinën e mallrave,
  - c) parandalimin, hetimin dhe luftën kundër veprave penale.
2. Me kërkesë të autoritetit kërkuar, autoriteti i kërkuar, sipas rasti, mban nën mbikqyrje të veçantë:
  - a) personat që njihen prej autoritetit doganor kërkuar që kanë kryer një veprë penale ose dyshohen për shkelje të legjislacionit doganor,
  - b) mallrat, gjatë transportit ose magazinimit, të njoftuar nga autoriteti kërkuar doganor, që përbëjnë trafik të paligjshëm të dyshuar drejt territorit të tij,
  - c) mjetet e transportit që njihen ose dyshohen nga autoriteti kërkuar doganor që përdoren për kryerjen e veprave penale doganore,
  - d) vendet e dyshuara nga autoriteti kërkuar doganor që përdoren për kryerjen e veprave penale doganore ose që përdoren për shkeljen e legjislacionit doganor.

3. Autoritetet doganore, sipas kërkesës, i japin njëra-tjetrës çdo informacion që tregon nëse:

- a) mallrat e importuara në territorin e një Pale Kontraktuese janë eksportuar ligjërisht nga territori i Palës tjetër Kontraktuese,
- b) Mallrat e importuara nga territori i një Pale Kontraktuese janë importuar ligjërisht në territorin e Palës tjetër kontraktuese, dhe për natyrën e procedurës doganore, sipas rastit, sipas të cilës janë futur mallrat.

#### Neni 4

##### Ndihma e rastësishme

Autoritetet doganore i japin njëra-tjetrës ndihmë pa kërkesë paraprake, nëse ato e çmojnë të nevojshme për zbatimin e saktë të legjislacionit doganor, veçanërisht nëse marrin informacion në lidhje me :

- a) operacionet që konsiderohen si shkelje e legjislacionit doganor,
- b) mjetet ose metodat e reja që zbatohen për ndërmarrjen e këtyre operacioneve,
- c) mallrat që dihet që përbëjnë shkelje të legjislacionit të doganave mbi importin, eksportin, tranzitin ose çdo procedurë tjetër doganore, veçanërisht lëndët toksike, substancat psikotrope dhe prekursorët e drogës.

#### Neni 5

##### Dorëzimi i kontrolluar

1. Duke patur parasysh ligjet, rregulloret dhe procedurat e tyre të brendshme, të dy autoritetet e Doganave, me anë të masave të përbashkëta, mund të zbatojnë metodën e dorëzimit të kontrolluar të lëndëve toksike, lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope dhe mallrave delikate, me qëllim zbulimin e personave të përfshirë në trafikimin e paligjshëm të këtyre lëndëve, substancave dhe mallrave dhe për t'i sekuestruar ato.
2. Dërgesat e paligjshme në lidhje me të cilat ushtrohet dorëzimi i kontrolluar, mund të kontrollohen dhe lejohen për transport të mëtejshëm me dërgesën e paligjshme të paprekur ose të hequr, ose zëvendësuar plotësisht apo pjesërisht.
3. Vendimet në lidhje me përdorimin e dorëzimeve të kontrolluara merren rast pas rasti.

#### Neni 6

Informacioni në lidhje me trafikimin e paligjshëm të mallrave delikate Autoritetet Doganore, me iniciativën e tyre ose sipas kërkesës dhe pa vonesë, i japin njëra-tjetrës të gjithë informacionin përkatës për aktivitetet që përbëjnë ose mund të

përbënin një vepër penale ndaj legjislacionit doganor në fuqi në territorin e njërës prej Palëve në fushën e:

- a) lëvizjes së armëve, municionit dhe aparateve eksplozivë;
- b) lëvizjen e objekteve të artit dhe antikuarëve që përbëjnë vlerë të rëndësishme historike, kulturore ose arkeologjike për një prej Palët;
- c) lëvizjen e lëndëve helmuese, materialeve bërthamore dhe radioaktive, si dhe substanca të tjera të rrezikshme për ambientin dhe shëndetin publik;
- d) lëvizjen e mallrave që i nënshtrohen tarifave dhe taksave të konsiderueshme doganore.

### Neni 7

#### Forma dhe përmbajtja e kërkesave për ndihmë

1. Kërkesat në pajtim me këtë Marrëveshje bëhen ~~me~~ shkrim. Dokumentet e nevojshëm për ekzekutimin e këtyre kërkesave shoqërojnë kërkesat. Nëse kushtëzohet nga urgjenca e situatës dhe me kusht që nuk ka mundësi dërgimi të tyre me faks, kërkesat gojore mund të pranohen, por duhet të konfirmohen menjëherë me shkrim.
2. Kërkesat në pajtim me paragrafin 1 të këtij Neni përfshijnë informacionin e mëposhtëm:
  - a) autoritetin Doganor kërkues,
  - b) masën e kërkuar,
  - c) objektin dhe shkakun e kërkesës,
  - d) ligjet, rregullat dhe elementët e tjerë ligjorë të përfshirë,
  - e) tregues sa më të saktë dhe të plotë që të jetë e mundur për personat fizikë dhe juridikë që janë objekt i hetimeve dhe, nëse dihen, mjetet e transportit,
  - f) një përmbledhje të fakteve përkatëse dhe të hetimeve të kryera.
3. Kërkesat paraqiten në gjuhën zyrtare të Shtetit të autoritetit Doganor të kërkuar, ose në gjuhën angleze.
4. Nëse një kërkesë nuk përmbush kërkesat formale, mund të kërkohej korigjimi ose plotësimi i saj; megjithatë, mund të ndodhë urdhërimi i masave parandaluese.

### Neni 8

#### Ekzekutimi i kërkesave

1. Kërkesat për ndihmë dhe hetime ekzekutohen në pajtim me ligjet, rregullat dhe instrumentet e tjera ligjore të Palës së kërkuar.

2. Me qëllim që të përmbushet një kërkesë për ndihmë, autoriteti i kërkuar vepron, brenda kompetencave dhe burimeve të veta në dispozicion, sikur të vepronte në emër të vet ose me kërkesë të autoriteteve të tjera të së njëjtës Palë, duke dhënë informacionin në zotërim, duke kryer hetimet e përshtatshme ose duke marrë masa që ato të kryhen.

3. Në rast se autoriteti Doganor i kërkuar nuk është agjencia e përshtatshme për të përmbushur kërkesën, ai mund t'ia kalojë kërkesën agjencisë së përshtatshme dhe, nëse kërkohet, për këtë vihet në dijeni autoriteti Doganor kërkues.

#### Neni 9

##### Prania gjatë hetimeve e nëpunësve të Palës kërkuese

1. Nëpunësit e autorizuar rregullisht të një Pale, në raste të veçanta me pëlqimin e autoritetit të kërkuar, brenda kushteve të caktuara nga ky i fundit dhe në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Shtetit të këtij të fundit, mund të jenë të pranishëm në hetimet e kryera në territorin e Shtetit të autoritetit tjetër Doganor. Hetimet kryhen nga nëpunësit e Palës në territorin e të cilës kryhen hetimet dhe nëpunësit e Palës tjetër mund të japin dhe të marrin informacion për këto hetime.

2. Nëse në kushtet e parashikuara në bazë të kësaj Marrëveshjeje, nëpunësit e një Pale janë të pranishëm në hetimet e kryera në territorin Palës tjetër, ata duhet të jenë gjithmonë në gjendje të paraqesin prova të cilësisë së tyre zyrtare dhe të identitetit të tyre. Ata nuk duhet të mbajnë uniformë dhe as të mbajnë armë dhe janë përgjegjës për çdo shkelje të rregullave të Palës ku kryhen hetimet.

3. Nëpunësit e autorizuar rregullisht të një Pale, në raste të veçanta me pëlqimin e autoritetit Doganor të përfshirë, në kushtet e caktuara nga ky i fundit dhe në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm të brendshëm dhe ndërkombëtar, mund të hipin në bordin e anijeve dhe avionëve të Palës tjetër, në operacione reale dhe gjithashtu në trajnime dhe stërvitje. Pala që është pronare e mjetit nuk mban përgjegjësi për dëmet që mund të pësojnë nëpunësit e Palës tjetër në bord aksidentalisht ose si rezultat i operacioneve.

4. Duke patur parasysh legjislacionin e brendshëm të Palëve dhe marrëveshjet ndërkombëtare që janë detyruese për Palët, anijet dhe avionët, me nëpunësit e Palës tjetër në bord, mund të kryejnë sekuestrimin e anijeve që kryejnë vepra penale kundër legjislacionit Doganor në ujrat territoriale të Palës kërkuese ose në ujrat ndërkombëtare.

Për të zbatuar dispozitat e paragrafit të mësipërm, Pala kërkuese merit autorizimet ligjore të nevojshme për t'u ngjitur në bord, inspektuar ose nëse është e nevojshme, të drejtojnë

në port anijen që kryen veprën penale, duke marrë përsipër shpenzimet që mund të shkaktohen nga dëmtimet ose pretendimet. Fakti që veprimi kryhet nga një anije që është në pronësi të Palës së kërkuar, tregohet në kërkesat për autorizim.

Nëse flamuri i anijes që kryen veprën penale është i Palës kërkuese, prezumohet që autorizimet e nevojshme janë lëshuar për shkak të pranisë së nëpunësve të saj në bordin e anijeve dhe avionëve të Palës së kërkuar.

#### Neni 10

##### Komunikimi i informacionit

1. Në kushtet dhe brenda kufijve të parashikuara në këtë Marrëveshje dhe me kusht që legjislacioni i brendshëm ta lejojë, autoritetet Doganore i japin njëra-tjetrës informacion në formën e dokumenteve, kopjeve të certifikuara, raporteve dhe të tjera në zotërimin e tyre.
2. Dokumentet e parashikuara në paragrafin 1, në diskrecionin e Palës së kërkuar, mund të zëvendësohen me informacion të kompjuterizuar të prodhuar në çdo lloj forme për të njëjtin qëllim.

#### Neni 11

##### Përdorimi i informacionit

1. Informacioni i marrë në bazë të kësaj Marrëveshjeje përdoret vetëm për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje. Ai mund të përdoret brenda çdo Shteti për qëllime të tjera vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të autoritetit Doganor që ka dhënë informacionin dhe i nënshtrohet çdo kufizimi të caktuar nga ai autoritet.
2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk pengojnë përdorimin e informacionit për çdo procedurë administrative apo gjyqësore të filluar më vonë për shkak të mosrespektimit të legjislacionit doganor.
3. Autoritetet doganore, në regjistrat e tyre të provave, raportet, deklaratimet dhe në gjykimet dhe paditë e ngritura në gjykatë, mund të përdorin si provë informacionin dhe dokumentet e marra në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.
4. Përdorimi i këtij informacioni dhe këtyre dokumenteve si provë në gjykatë dhe pesha që u jepet atyre caktohet në pajtim me ligjin e brendshëm të Palëve.

## Neni-12

## Konfidencialiteti i informacionit

1. Çdo informacion i dhënë në çfarëdolloj forme në pajtim me këtë Marrëveshje është i natyrës konfidenciale. Ai mbulohet nga detyrimi i sekretit zyrtar dhe gëzon mbrojtjen që i jepet informacionit të ngjashëm në bazë të legjislacionit përkatës të zbatueshëm tek Pala që e ka marrë atë.
2. Të dhënat nominative nuk transmetohen kurdoherë që ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se transferimi ose përdorimi i të dhënave të transmetuara do të ishte në kundërshtim me parimet ligjore bazë të një prej Palëve, dhe veçanërisht, nëse personi përkatës do të vuante një cënim të të drejtave themelore të njeriut. Sipas kërkesës, Pala kërkuese informon Palën që ka dhënë informacionin për përdorimin e bërë në lidhje me informacionin e dhënë dhe rezultatet e arritura.
3. Të dhënat nominative mund t'u transmetohen vetëm autoriteteve Doganore dhe, në rastin e nevojës për qëllime të hetimit, autoriteteve të prokurorisë dhe atyre gjyqësore. Autoritete ose persona të tjerë mund të marrin informacion të tillë vetëm me autorizim paraprak nga autoriteti dhënës.

## Neni 13

## Ekspertët dhe dëshmitarët

Një nëpunës i një autoriteti kërkues mund të autorizohet të paraqitet, me kufizimet e autorizimit të dhënë, si ekspert ose dëshmitar në procedurat administrative ose gjyqësore në lidhje me çështjet e mbuluara nga kjo Marrëveshje në juridiksionin e Shtetit tjetër dhe të japin ato objekte, dokumente ose kopje të vërtetuara të tyre, që mund të kërkohen në procedurë. Kërkesa për paraqitje duhet të tregojë në mënyrë specifike për cilat çështje dhe në cilën cilësi apo kualifikim do të pyetet nëpunësi.

## Neni 14

## Përjashtimet nga përgjegjësia për dhënien e ndihmës

1. Nëse autoriteti i kërkuar mendon që përmbushja e kërkesës do të dëmtojte sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose një interes tjetër thelbësor të Shtetit të tij ose do të kishte të bënte me shkeljen e një sekretit industrial, tregtar ose profesional, ai mund të refuzojë të japë ndihmën e kërkuar në bazë të kësaj Marrëveshjeje, mund ta japë pjesërisht ose ta japë duke caktuar kushte apo kërkesa të caktuara.

2. Nëse autoriteti kërkues kërkon ndihmë të cilën ai nuk do të ishte në gjendje ta jepte nëse i kërkohet nga autoriteti tjetër Doganor, ai e shënon këtë fakt në kërkesë. I lihet autoritetit të kërkuar të vendosë si t'i përgjigjet kësaj kërkesë.

3. Nëse ndihma nuk jepet apo refuzohet, vendimi dhe arsyet për këtë duhet t'i njoftohen me shkrim autoritetit të kërkuar pa vonesë.

#### Neni 15

##### Shpenzimet e ndihmës

1. Autoritetet doganore heqin dorë nga të gjitha pretendimet ndaj njeri-tjetrit për riimbursimin e shpenzimeve që shkaktohen nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, përveç shpenzimeve për të paguar ekspertët dhe dëshmitarët dhe shpenzimet për përkthyesit dhe interpretët që nuk janë në ushtrim të shërbimeve të tyre publike.

2. Nëse për përmbushjen e një kërkesë kërkohen shpenzime të një natyre thelbësore ose të jashtëzakonshme, Palët konsultohen për të caktuar termat dhe kushtet në të cilat do të ekzekutohet kërkesa dhe mënyrën në të cilën do të mbulohen shpenzimet.

#### Neni 16

##### Zbatimi i Marrëveshjes

1. Bashkëpunimi dhe ndihma e dhënë në pajtim me këtë Marrëveshje jepet drejtpërdrejt nga autoritetet Doganore. Këto autoritete bien dakord bashkërisht për masat e detajuara për këtë qëllim.

2. Të dy autoritetet Doganore mund të organizojnë kontakte të drejtpërdrejta të organeve të zbatimit dhe ligjit dhe të hetimit dhe, sipas rastit, edhe të tjera, me qëllim lehtësimin nëpërmjet shkëmbimit të informacionit mbi parandalimin, hetimin dhe shtypjen e shkeljeve të ligjeve dhe rregulloreve doganore. Shkëmbëhet dhe përditësohet një listë me nëpunësit e caktuar nga autoritetet Doganore.

3. Autoritetet doganore mund të bien dakord të takohen për të rishikuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 17

##### Zbatimi territorial

Kjo Marrëveshje zbatohet në territorin Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe në territorin Doganor të Mbretërisë së Spanjës.

## Neni 18

## Hyrja në fuqi dhe prishja

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e tridhjetë nga data e njoftimit të fundit me shkrim, me anë të kanaleve diplomatike, që komunikojnë se Palët kanë përbushur procedurat përkatëse të brendshme të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.
2. Kjo Marrëveshje përfundohet për një kohëzgjatje të pakufizuar dhe mbetet në fuqi gjashtë muaj pas datës së një njoftimi me shkrim me anë të kanaleve diplomatike të një prej Palëve, në lidhje me synimin e saj për ta prishur Marrëveshjen.

Bërë në ....., më ..... 200\_ në tre kopje origjinale në gjuhët shqipe, spanjolle dhe angleze, dhe të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast mospërputhje në interpretim, ka përparësi teksti në gjuhën angleze.

Për Qeverinë e  
Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e  
Mbretërisë së Spaujës

AGREEMENT

BETWEEN

THE GOVERNMENT OF

THE REPUBLIC OF ALBANIA

AND

THE GOVERNMENT

OF THE KINGDOM OF SPAIN

REGARDING

COOPERATION AND

MUTUAL ASSISTANCE

IN CUSTOMS MATTERS

The Government of the Republic of Albania and the Government of the Kingdom of Spain, hereinafter referred to as the Parties,

Considering that offences against customs legislation are detrimental to the economic, fiscal and social interests of their respective States, as well as to the legitimate interests of trade;

Considering that illicit trafficking in narcotic drugs, psychotropic substances and other hazardous goods constitutes a danger to public health and to society;

Considering the importance of assuring the accurate assessment of customs duties, and taxes collected at importation or exportation of goods and the proper implementation of the provisions of prohibition, restriction and control;

Convinced that efforts to prevent offences against customs legislation and efforts to ensure accurate collection of import and export duties and taxes can be made more effective through co-operation between their Customs authorities;

Having regard to the Recommendation of the Customs Co-operation Council on Mutual Administrative Assistance of December 5, 1953;

Having regard also to the single Convention on Narcotic Drugs (New York, 1961), the Convention on Psychotropic Substances (Vienna, 1971) and the Convention against Illicit Traffic in Narcotic Drugs and Psychotropic Substances (Vienna, 1988);

Have agreed as follows:

# ARTICLE 1

## Definitions

For the purposes of this Agreement:

- a) "Customs authority" shall mean:
- In the Republic of Albania, the Directorate General of Customs of the Ministry of Finance
  - In the Kingdom of Spain: The Ministry of Economy and Finance without prejudice to the competences corresponding to other Ministries.
- b) "Customs legislation" shall mean any legal or regulatory provisions enforced by the Customs authorities governing the import, export and transit of goods, and also any customs procedures or regimes, whether relating to customs duties and taxes or to measures of prohibition, restriction or control, including illegal traffic of drugs and other goods;
- c) "Offences" shall mean any violation of customs legislation as well as any attempted violation of such legislation;
- d) "Customs duties" shall mean all duties, taxes and fees levied and collected by customs authorities;
- e) "Person" shall mean any natural or legal person;
- f) "Requesting authority" shall mean the Customs authority which makes a request for assistance in customs matters;
- g) "Requested authority" shall mean Customs authority which receives a request for assistance in customs matters;

h) "Controlled delivery" shall mean the technique of allowing illicit consignments which contain, or are suspected of containing, narcotic drugs, psychotropic substances, substances substituted for them, or sensitive goods, to pass out of, through, or into the territories of the Parties, with the knowledge and under the supervision of the competent authorities, for the purpose of facilitating the investigations.

## ARTICLE 2

### Scope of the Agreement

- 1.- The Customs authorities of the Parties shall assist each other under the terms set out in this Agreement in order to facilitate the legal movement of goods, to apply the Customs legislation and also in the prevention, investigation and combating of offences in the above mentioned fields.
- 2.- Mutual assistance within the framework of this Agreement shall be rendered in accordance with the legislation in force in the territory of the State of the requested Party and within the competence and available resources of the requested Customs authority.
- 3.- The content of this Agreement will not affect the mutual assistance concerning criminal matters, that shall be rendered in accordance with the legislation in force in the territories of the Parties and in accordance with international Agreements signed by the Parties.

## ARTICLE 3

### Assistance upon request

- 1.- Upon request of the requesting authority, the requested authority shall provide the requesting authority with any useful information related to:
  - a) The proper implementation of the Customs legislation and substantial changes in those legislations;

- b) The correct assessment of customs duties, especially that information pertaining to the determination of the customs value, tariff classification and the origin of the goods;
- c) The prevention, investigation and repression of offences.

2.- Upon request of the requesting authority the requested authority shall maintain, whenever possible, special surveillance over:

- a) Persons known to the requesting Customs authority to have committed an offence or suspected of contravening the Customs legislation;
- b) Goods, either in transport or storage, notified by the requesting Customs authority as giving rise to suspected illicit traffic towards its territory;
- c) Means of transport known to be or suspected of being used to commit customs offences by the requesting Customs authority;
- d) Places suspected by the requesting Customs authority of being used to commit customs offences or being used for contravening Customs legislation.

3.- The Customs Authorities shall, upon request, supply to each other any information showing if:

- a) Goods imported into the territory of one Contracting Party have been lawfully exported from the territory of the other Contracting Party;
- b) Goods exported from the territory of one Contracting Party have been lawfully imported into the territory of the other Contracting Party, and the nature of the customs procedure, if any, under which the goods have been placed.

#### ARTICLE 4

##### Spontaneous assistance

The Customs authorities shall provide each other assistance without prior request where they consider that to be necessary for the correct application of Customs Legislation, particularly when they obtain information pertaining to:

- a) Operations considered in contravention of Customs legislation;
- b) New means or methods employed for undertaking such operations;
- c) Goods known to be subject to contravention of customs legislation on import, export, transit or any other customs procedure, especially toxic drugs, psychotropic substances and drug precursors.

## ARTICLE 5

### Controlled delivery

- 1.- Having regard to their national laws, regulations and procedures, both Customs authorities may, by mutual arrangement, carry out the method of controlled delivery of toxic drugs, narcotic drugs, psychotropic substances and sensitive goods with the aim of bringing to light persons involved in the illicit trafficking of those drugs, substances and goods and also to seize them.
- 2.- Unlawful consignments in respect of which controlled deliveries are carried out may be intercepted and left for onward transportation with the unlawful consignment intact or removed or wholly or partially replaced.
- 3.- Decisions concerning the use of controlled deliveries are to be taken on a case-by-case basis.

## ARTICLE 6

### Information about illicit traffic of sensitive goods

The Customs authorities shall, on their own initiative or upon request and without delay, supply to each other all relevant information on activities, which constitute or could constitute an offence against the Customs legislation in force in the territory of one of the Parties in the field of:

- a) Movement of arms, ammunition, explosives and explosive devices;
- b) Movement of objects of art and antiquity, which present significant historical, cultural or archaeological value for one of the Parties;
- c) Movement of poisonous goods, nuclear and radioactive materials as well as other substances dangerous for the environment and the public health;
- d) Movement of goods subject to substantial customs duties or taxes;

## ARTICLE 7

### Form and substance of requests for assistance

- 1.- Requests pursuant to this Agreement shall be made in writing. Useful documents for the execution of such requests shall accompany the requests. When required because of the urgency of the situation and provided that the possibility of sending them by fax does not even exist, oral requests may be accepted, but must be confirmed in writing immediately.
- 2.- Requests pursuant to paragraph 1 of this Article shall include the following information:
  - a) The requesting Customs authority;
  - b) The measure requested;
  - c) The object of and the reason for the request;
  - d) The laws, rules and other legal elements involved;
  - e) Indications as exact and comprehensive as possible on the natural or legal persons being the target of the investigations and, whenever known, on the means of transport;
  - f) A summary of the relevant facts and of the enquiries already carried out.

3.- Requests shall be submitted in the official language of the State of the requested Customs authority, or in English.

4.- If a request does not meet the formal requirements, its correction or completion may be demanded; the ordering of precautionary measures may, however, take place.

## ARTICLE 8

### Execution of requests

1.- Requests for assistance and enquiries shall be executed in accordance with the laws, rules and other legal instruments of the requested Party.

2.- In order to comply with a request for assistance, the requested authority shall proceed, within its competence and available resources, as though it were acting on its own account or at the request of other authorities of that same Party, by supplying information already possessed, by carrying out appropriate enquiries or by arranging for them to be carried out.

3.- In case the requested Customs authority is not the appropriate agency to comply with the request, it may promptly transmit the request to the appropriate agency and, if requested, the requesting Customs authority shall be so informed.

## ARTICLE 9

### Presence at the enquiries of officials of the requesting Party

1.- Duly authorized officials of one Party may, in particular cases with the agreement of the requested authority, within the conditions laid down by the latter, and under the national legislation of the State of the latter, be present at enquiries carried out in the territory of the State of the other Customs authority. The enquiries will be carried out by the officials of the Party in which territory the enquiries are being carried out, and the officials of the other Party may provide and receive information on those enquiries.

- 2.- When, in the circumstances provided for under this Agreement, officials of one Party are present at enquiries carried out in the territory of the other Party, they must at all times be able to furnish proof of their official capacity and identity. They must not wear uniform nor carry arms and shall be responsible for any offences against the rules of the Party where the enquiries are being carried out.
- 3.- Duly authorized officials of one Party may, in particular cases with the agreement of the Customs authority involved, within the conditions laid down by the latter, and under the national or international applicable legislation, get on board of the ships and aircrafts of the other Party, in real operations and also in training and exercises. The Party that is the owner of the means is exonerated from the damages the officials of the other Party on board could suffer by accident or as a result of the operations.
- 4.- Having regard to the national legislation of the Parties and international agreements binding for the Parties, the ships and aircrafts may, with officials of the other Party on board, proceed to the seizure of ships that commit offences against the Customs legislation in the territorial sea of the requesting Party or in high seas.

To put into effect the provisions of the above paragraph, the requesting Party shall obtain the legal authorisations necessary to board up, inspect or, when required, lead to port the ship committing the offence, assuming the costs that could be originated by damages or claims. The fact that the action will be carried out by a ship owned by the requested Party shall be stated in the requests for authorization.

When the flag of the ship committing the offence is that of the requesting Party, it shall be taken for granted that the necessary authorizations have been issued because of the mere presence of its officials on board of the ships and aircrafts of the requested Party.

## ARTICLE 10

### Communication of information

- 1.- Under the conditions and within the limits laid down in this Agreement, and provided that the national legislation allows it, the Customs authorities shall communicate each other information in the form of documents, certified copies of documents, reports and the like already in their possession.
- 2.- The documents provided for in paragraph 1 may be, at the discretion of the requested Party, replaced by computerized information produced in any form for the same purpose.

## ARTICLE 11

### Use of information

- 1.- Information obtained under this Agreement shall be used solely for the purposes of this Agreement. It may be used within each State for other purposes only with the prior written consent of the Customs authority, which furnished the information and shall be subject to any restrictions laid down by that authority.
- 2.- The provisions of paragraph 1 shall not impede the use of information in any judicial or administrative proceedings subsequently instituted for failure to comply with Customs legislation.
- 3.- The Customs authorities may, in their records of evidence, reports and testimonies and in proceedings and charges brought before the courts, use as evidence information obtained and documents received in accordance with the provisions of this Agreement.
- 4.- The use made of such information and documents as evidence in courts and the weight to be attached thereto shall be determined in accordance with the national law of the Parties.

## ARTICLE 12

### Confidentiality of information

- 1.- Any information communicated in whatsoever form pursuant to this Agreement shall be of a confidential nature. It shall be covered by the obligation of official secrecy and shall enjoy the protection extended to like information under the relevant legislation applicable in the Party, which received it.
- 2.- Nominative data shall not be transmitted whenever there are reasonable grounds to believe that the transfer or the use of the data transmitted would be contrary to the basic legal principles of one of the Parties, and, in particular, if the person concerned would suffer a prejudice to fundamental human rights. Upon request, the receiving Party shall inform the furnishing Party of the use made of the information supplied and of the results achieved.
- 3.- Nominative data may only be transmitted to customs authorities and, in the case of need for prosecution purposes, to public prosecution and judicial authorities. Other persons or authorities may obtain such information only upon previous authorization by the furnishing authority.

## ARTICLE 13

### Experts and witnesses

An official of a requested authority may be authorized to appear, within the limitations of the authorization granted, as expert or witness in judicial or administrative proceedings regarding the matters covered by this Agreement in the jurisdiction of the other State, and produce such objects, documents or authenticated copies thereof, as may be needed for the proceedings. The request of an appearance must indicate specifically on what matters and by virtue of what title or qualification the official will be questioned.

## ARTICLE 14

### Exemptions from the liability to provide assistance

- 1.- If the requested authority considers that compliance with the request would be prejudicial to the sovereignty, security, public order or any other essential interest of its State or would involve violation of an industrial, commercial or professional secret, it may refuse to provide the assistance requested under this Agreement, provide it partially, or provide it limited to certain conditions or requirements.
- 2.- If the requesting authority asks for assistance which it would itself be unable to provide if asked for by the other Customs authority, it shall draw attention to that fact in its request. It shall be left to the requested authority to decide how to respond to such a request.
- 3.- If assistance is withheld or refused, the decision and the reasons therefore must be notified in the written form to the requested authority without delay.

## ARTICLE 15

### Costs of assistance

- 1.- The Customs authorities shall waive all claims on each other for the reimbursement of costs incurred in the execution of this Agreement, except for expenses paid to experts and witnesses as well as costs of interpreters and translators who are not dependent upon public services.
- 2.- If expenses of a substantial and extraordinary nature are or will be required to execute the request, the Parties shall consult to determine the terms and conditions under which the request will be executed as well as the manner in which the cost shall be borne.

## ARTICLE 16

### Implementation of the Agreement

- 1.- The cooperation and assistance provided for under this Agreement shall be rendered directly by the Customs authorities. Those authorities shall mutually agree on detailed arrangements for that purpose.

- 2.- Both Customs authorities may organize direct contact between their law enforcement, investigation and, if appropriate, other divisions with a view to facilitating by means of exchanging information on the prevention, investigation and repression of contraventions of customs laws and regulations. A list of designated officials shall be exchanged and kept updated by the Customs authorities.
- 3.- The Customs authorities might agree to meet in order to review the application of this Agreement.

## ARTICLE 17

### Territorial application

This Agreement will be applicable on the Customs territory of Republic of Albania and in the Customs territory of the Kingdom of Spain.

## ARTICLE 18

### Entry into force and termination

- 1.- This Agreement shall enter into force on the thirtieth day from the date of the last written notification, through diplomatic channels, communicating that the respective internal procedures necessary for its entry into force have been fulfilled by the Parties.
- 2.- This Agreement is concluded for an unlimited duration and shall stay in force six months after the date of a written notification through diplomatic channels of one of the Parties about its intention to terminate the Agreement.

Done in ....., on ..... 200\_ in three originals in the Albanian, Spanish and English languages, all texts being equally authentic. In case of divergency of interpretation, the English text shall prevail.

For the Government of the  
Republic of Albania

For the Government of the  
Kingdom of Spain